



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E SHËNDETËSISË
DHE MBROJTJES SOCIALE

KOMISIONI I MBROJTJES NGA RREZATIMET

Nr. 72/5 prot

Tiranë, më 08.01.21

Lënda: Amendim i procedurës së aplikimit dhe vlerësimit për licencë për veprimtari me burime të rrezatimit jonizues 490/7 datë 19.5.2020.

Në zbatim të rregullores Nr.877, datë 30.10.2015 "Për sigurimin e burimeve radioaktive në Republikën e Shqipërisë", udhëzuesit Nr.444/8, datë 29.3.2019 "Për përgatitjen e planit të sigurimit të objektit", si dhe në kuadër të marrëveshjes së bashkëpunimit të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale me Ministrinë e Brendshme, aplikimi për licencë për të gjithë subjektet që kanë në përdorim burime radioaktive të kategorisë 1, 2 dhe 3 duhet të bëhet duke ndjekur hapat e mëposhtëm:

1- Në zbatim të nenit 6 pika 3 (a), nenit 7 pika 3(a) dhe nenit 8 pika 4 (c) të rregullores Nr. 877 datë 30.10.2015 "Për sigurimin e burimeve radioaktive në Republikën e Shqipërisë", të gjithë subjektet që përdorin burime radioaktive të kategorisë 1, 2 dhe 3 duhet të dërgojnë fillimisht në ZMR listën e punonjësve që do të kenë akses me burimet radioaktive të kategorisë 1, 2 dhe 3, me qëllim dërgimin në strukturat përkatëse për verifikimin e besueshmërisë dhe përshtatshmërinë të tyre.

2- Më tej pas marrjes së konfirmimit nga strukturat përkatëse mbi përshtatshmërinë e stafit, në zbatim të nenit 6 pika 1, nenit 7 pika 1 dhe nenit 8 pika 1 të rregullores Nr. 877 datë 30.10.2015 "Për sigurimin e burimeve radioaktive në Republikën e Shqipërisë", subjekti i cili kërkon të pajiset me licencë/amendojë licencën për veprimtari me burime të rrezatimit jonizues, duhet të përgatisë planin e sigurimit, në përputhje me udhëzuesin Nr.444/8, datë 29.3.2019 "Për përgatitjen e planit të sigurimit të objektit" dhe në bashkëpunim me strukturat vendore të Policisë së Shtetit (drejtoria vendore e policisë/ komisariati i policisë), aty ku kompania ushtron veprimtarinë me burime radioaktive të kategorisë 1, 2 dhe 3.

Pas plotësimit të pikës 1 dhe 2, i gjithë dokumentacioni sipas pikave në aplikimin për licencë për veprimtari me burime të hapura/të mbyllura radioaktive dorëzohet pranë ZMR tek personi i ngarkuar për këtë qëllim ose në adresën elektronike zyrtare të ZMR, ose siç e specifikon legjislacioni i sistemeve elektronike, por jo me postë normale.

Dokumentacioni do të vlerësohet më tej sic përcaktohet në dokumentin 490/7 datë 19.5.2020 "procedurat e aplikimit dhe vlerësimit për licencë për veprimtari me burime të rrezatimit jonizues".

SEKRETARI
Rustem PACI

KRYETARI
Ogerta MANASTIRLIU